

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

MIDIS

**MINISTRIT TË SHËNDETËSISË DHE PRESIDENTIT TË URDHRI TË MJEKËVE
TË SHQIPËRISË**

Ministri i Shëndetësisë dhe Presidenti i Urdhrit të Mjekëve të Shqipërisë (në vijim të quajtura “Palët”)

Duke vlerësuar rëndësinë e ushtrimit të profesionit të mjekut dhe stomatologut në mënyrë sa më korrekte dhe në shërbim të plotë të populates,

Duke konsideruar si një ndër objektivat prioritarë në ushtrimin e veprimtarisë së tyre përmirësimin e cilësisë së kujdesit shëndetësor në të gjithë vendin dhe zbatimin e angazhimeve reciproke për arritjen e këtij qëllimi,

Duke afirmuar vullnetin e mirë dhe vendosmërinë e tyre për të bashkëpunuar dhe kontribuar në mënyrë konstruktive dhe thelbësore në funksion të realizimit të qëllimit të këtij memorandumi;

Duke u mbështetur në kuadrin e plotë ligjor që normon veprimtarinë e tyre institucionale dhe administrative: Ligjin Nr. 10107, datë 30.03.2009 "Për Kujdesin Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë", Ligjin Nr. 8615, datë 01.06.2000 “Për Urdhrin e Mjekëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe Ligjin Nr. 10171 “Për Profesionet e Rregulluara në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar,

Kanë rënë dakord të lidhin këtë Memorandum Bashkëpunimi (në vijim “Memorandum”).

**Neni 1
Qëllimi**

Qëllimi i memorandumit është bashkëpunimi ndërmjet dy institucioneve për mënyrën e ushtrimit të profesionit të mjekut apo stomatologut sipas legjislacionit në fuqi si dhe për kryerjen e praktikës mjekësore në përshtatje me parimet e Kodit të Etikës dhe deontologjisë mjekësore

Neni 2

Forma e bashkëpunimit

1. Bashkëpunimi sipas këtij Memorandumi realizohet nëpërmjet:
 - a. ngritjes së grupeve të përbashkëta të kontrollit për zbatimin e standarteve ligjore dhe etiko-morale nga ana e institucioneve shëndetësore
 - b. shkëmbimit të informacioneve reciproke në funksion të përmirësimit të cilësisë së ushtrimit të profesionit të mjekut dhe stomatologut në institucionet e kujdesit shëndetësor.
 - c. ndërmarrjen e veprimeve të përbashkëta për ndreqjen e mangësive të konstatuara gjatë ushtrimit të kontrolleve të përbashkëta

Neni 3

Angazhimet e Ministrisë së Shëndetësisë

1. Ministria e Shëndetësisë përmes strukturave të saj merr përsipër kryerjen e detyrave të mëposhtme:
 - a. Të mos lejojë ushtrimin e profesionit të mjekut dhe stomatologut në institucionet e kujdesit shëndetësor pa u pajisur me të Lejen (licensën) e Ushtrimit të Profesionit nga Udhërimi i Mjekëve,
 - b. Të krijojë lehtësira për Urdhërimin e Mjekëve të hyrjes në institucionet shëndetësore për monitorimin dhe kontrollin e standarteve profesionale dhe zbatimin nga ana e mjekëve dhe stomatologëve të Kodit të Etikës dhe Deontologjisë Mjekësore
 - c. Të mbështesë bashkëpunimin e Urdhërit të Mjekëve dhe Qendrës Kombëtare të Edukimit në Vazhdim për sigurimin e standardeve të larta në formimin dhe ushtrimin e profesioneve mjekësore
 - d. Të denoncojë çdo rast kundravajtje të kryer nga mjekët në institucionet e saj vartëse, të cilët dhunojnë standardet dhe parimet e Kodit të Etikës dhe Deontologjisë Mjekësore.
 - e. Të garantojë ekzekutimin e masave disiplinore që janë marrë në gjykimin disiplinor profesional nga organet e Urdhrit.
 - f. Të mbështesë Urdhërimin e Mjekëve sipas rastit me specialistët përkatës për kryerjen e ekspertizave gjatë gjykimeve disiplinore profesionale të ndërmara nga urdhërimi i Mjekëve.

Neni 4

Angazhimet e Urdhërit të Mjekëve

1. Urdhërimi i Mjekëve të Shqipëtrisë merr përsipër kryerjen e detyrave të mëposhtme:
 - a. T'i sigurojë Ministrisë së Shëndetësisë dhe institucioneve të saj të vartësisë informimin e domosdoshëm mbi mangësitë e konstatuara gjatë veprimtarisë monitoruese e kontrolluese si dhe bashkëpunimin e nevojshëm për ndreqjen e tyre.
 - b. Të sigurojë pjesëmarrjen e përfaqësuesve të tij në ekipet e përbashkëta të kontrollit me Ministrinë e Shëndetësisë

- c. Të shqyrtojë dhe të kalojë në proces të Gjykimit Disiplinor Profesional çdo rast të denoncuar për veprime që përbëjnë kundravajtje dhe dhunim të Kodit të Etikës dhe Deontologjisë Mjekësore, duke marrë masat ndëshkimore përkatëse.
- d. Të informojë Ministrinë e Shëndetësisë për ecurinë e proceseve disiplinore dhe për masat e marra.
- e. Të informojë Ministrinë e Shëndetësisë për ecurinë e procesit të zhvillimit të praktikës mjekësore nga ana e mjekëve dhe për procesin e testimit të tyre.

Neni 5

Ndryshimi i Memorandumit

1. Ky memorandum mund të ndryshojë vetëm me marrëveshje të palëve nëpërmjet shkëmbimit të komunikimit me shkrim.

Neni 6

Afati i Memorandumit

1. Ky memorandum lidhet për një afat të pacaktuar. Palët mund të bien dakord në çdo kohë për përfundimin e këtij memorandum.

Neni 7

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Çdo mosmarrëveshje lidhur me interpretimin ose zbatimin e këtij memorandumi zgjidhet me mirëkuptim mes palëve.

Neni 8

Hyrja në Fuqi

1. Memorandum i Bashkëpunimit hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij dhe publikohet në faqet zyrtare të internetit të palëve.

Memorandumi përgatitet dhe nënshkruhet në 4 (katër) kopje origjinale, 2 (dy) prej të cilave depozitohen në Ministrinë e Shëndetësisë dhe 2 (dy) të tjerat pranë Urdhërit të Mjekëve.

MINISTRI I SHËNDETËSISË

Z. VANGJEL TAVO d.v.

PRESIDENTI I URDHËRIT TË MJEKËVE

DR. DIN ABAZAJ d.v.

This document was created with Win2PDF available at <http://www.win2pdf.com>.
The unregistered version of Win2PDF is for evaluation or non-commercial use only.
This page will not be added after purchasing Win2PDF.